

VENDIM
Nr. 312, datë 6.5.2026

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT, PËR
QENDRËN KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË DHE PËR NJË NDRYSHIM
NË VENDIMIN NR. 471, DATË 9.7.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË TRUALLIT, TË NDËRTESES
SË KORPUSIT QENDROR DHE SIPËRFAQES FUNKSIONALE TË TIJ, ‘ISH-
KINOSTUDIO’, NGA ‘ALBA FILM’ SHA, TE MINISTRIA E KULTURËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, sipas formularit 1 (një) fletë dhe fragmentit të hartës kadastrale 1 (një) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për ushtrimin e veprimtarisë, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga sipërfaqja e truallit funksional dhe sipërfaqja ndërtimore, pjesë të vendimit nr. 471, datë 9.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të truallit, të ndërtesës së korpusit qendror dhe sipërfaqes funksionale të tij, ‘Ish-Kinostudio’, nga ‘Aba Film’ sh.a., te Ministria e Kulturës”.

3. Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Qendrës Kombëtare të Kinematografisë u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi dhe ta tjetërsojnë atë.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Qendra Kombëtare e Kinematografisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni Qendror: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit				Identifikoi: MIRELA ALLIU, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE					
Bashkia : Tiranë				Supervizoi: BENIDA KRAJA, DREJTORI I PËRGJITHSHËM, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE					
Fusha e përdorimit të pronës: Monument kulture, Kategoria e II-të				Aprovoi: LLAMBRIOLA MISTO, SEKRETAR I PËRGJITHSHËM					
Nr. Rend.	Zona Kadastrale & Indeksi i Hartes	Nr. pasurisë	A		B		Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënim të veçanta)
			Lloji i pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndërtesë (m ²)			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	ZK.8130 TR-I-17	4/421	Truall+Ndertesë	Ish -Kinostudio "Shqipëria e Re", Rr.: A.Moisia, Tiranë	585	585	Administratë	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit	Qendra Kombëtare e Kinematografisë




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE:	<u>8130</u>	KODI UNIK:	<u>8130036174</u>
NUMRI PASURISË:	<u>4/421</u>	INDEKSI HARTËS:	<u>TR-I-17</u>

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 500

DREJTORI
Egreta Drenova

Entela
Dhima
Digitally signed by:
Entela Dhima
Date: 2026.04.20
11:14:25 +02'00'

Egreta
Drenova
Digitally signed by:
Egreta Drenova
Date: 2026.04.21
08:46:28 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tiranë Veri
Date: 2026.04.20 11:14:25 +02'00'
J91326001 G202604201114158414014

Shënim : Ky dokument është gëneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

SHPJEGUES

PARCELA
 NDËRTESA